



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No. 01 / 113	
07. 02. 2023	
PRISHTINË - A	

**PËR:** Jeton Krasniqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega ne Gllogoc  
**PREJ:** Muhamet Rexha, Kryetar i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore  
**LËNDA:** Përgjigje  
**DATA:** 06.02.2023

I nderuar gjyqtar Krasniqi,

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (me tutje KKEGJ), ka pranuar kërkesën tuaj të datës 31 janar 2023, për dhënie të opinionit këshillëdhënës, lidhur me trajtimin e lëndës së vërtetimit të pronësisë të cilat nuk janë të natyrës urgjente kur raportet e palëve ndërgjyqëse janë të acaruar.

Bazuar në nenin 1,7 dhe 9, të Rregullores Nr.01/2022, për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, Komiteti ka shqyrtuar kërkesën tuaj në takimin e mbajtur me datë 6 shkurt 2023. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, KKEGJ ka ardhur në përfundim se çështja e parashtruar nga ju është e trajtuar në Opinionin Këshillëdhënës KKEGJ.nr.01/2022, të datës 13.04.2022, i cili për objekt shqyrtimi ka pasur temën: “Standardet etike të zbatueshme, në rastin e barazisë së palëve, trajtimin të lëndëve gjyqësore sipas prioritetit dhe radhës së regjistrimit të tyre në gjykatë”, i cili është publikuar në web faqen e KGJK-së.

Në lidhje me çështjen e ngritur nga ana juaj, në pikën V të këtij opinionit këshillëdhënës, janë dhënë konkluzionet përfundimtare, ku ndër të tjera konstatohet se: “Gjyqtarët duhet ti trajtojnë lëndët sipas radhës dhe kronologjisë kohore të regjistrimit të tyre në gjykatë. Respektimi i këtij parimi, siguron në mënyrë efektive trajtimin e barabartë të palëve në procedure gjyqësore, përfshirë këtu edhe aspektin kohor të dhënies së drejtësisë së kërkuar...”. Ndërsa pjesët tjera të konkluzioneve përcaktojnë detyrimet e gjyqtarëve në respektimin e rregullave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, në raport me respektimin e parimit për trajtim të barabartë të palëve, por edhe përgjegjësitë dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerr menaxhmenti i gjykatës nëse konstatohen shkelje të këtij parimi nga ana e gjyqtarëve.

Meqenëse, KKEGJ-it i ka rezultuar se për çështjen e ngritur nga ana juaj ligji nuk i ka dhënë prioritet, rrjedhimisht edhe ka ardhur në përfundim se nuk është e nevojshme që të jap opinion të ri lidhur më këtë çështje.

Komiteti sugjeron qe për çështjen e ngritur mund të i drejtoheni edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës si organ kompetent për administrimin e gjyqësorit.

Sidoqoftë, KKEGJ e vlerëson lartë kontributin tuaj profesional për çështjen e ngritur, si dhe ju inkurajon juve dhe gjyqtarët tjerë që për të gjitha dilemat rreth shkeljeve të mundshme, ti drejtoheni Komitetit.

Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunim!